



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.07.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 01.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EJONA" për aktivitetin **:"Rregullimi dhe montimi i pompave për furnizim me uje ne ndertesat kolektive"** dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1481-521 nxjerr:

### VENDIM

1. Refuzohet kërkesa e Operatorit Ekonomik "EJONA" e datës 01.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **:"Rregullimi dhe montimi i pompave për furnizim me uje ne ndertesat kolektive"** dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1481-521 "kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së ,dërguar me datën 27.06.2019 dhe publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Vertetohet Vendimi për anulim i publikuar me datë: 27.06.2019;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "EJONA" me datë 01.07.2019 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:**:"Rregullimi dhe montimi i pompave për furnizim me uje ne ndertesat kolektive"** dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1481-521. Autoriteti Kontraktues, me datë 03.07.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me refuzimin e tenderit të tij për shkak se çmimet e tenderit të tij janë trajtuar si çmimi me të larta se sa çmimi i tregut dhe ka paraqitur disa tabela të çmimeve kinse për të bindur AK-ne për çmimet e tij. I sqarojme pretenduesit se AK-ja ka analizuar me kujdes të gjithë tenderet e pranuar dhe ka refuzuar edhe tenderet me çmime abnormalisht të ulta edhe ato me çmime

me te larta nga çmimet e tregut. Lidhur me çmimet e te njejtit sqarojme se AK-ja vleresimin e çmimeve e bene ne baze te krahasimit te çmimeve te ofruara nga te gjithë tenderuesit. Ne baze te analizes se çmimeve te tyre rrjedh se çmimi mesatar i tenderit eshte 9.880.00 euro, ndersa nese merren per baze vetem tenderet tjere mesatarja e tyre eshte 5.902.10 euro. Poashtu te pozicionet kyçe-pompat çmimet e pretenduesit jane mestaraisht gjashte fish me te larta nga çmimet e tenderuesit te parafundit nga çmimi per njesi (jo çmimi i poentuar) dhe ky eshte tregues i qarte per nivelin e ketyre çmimeve. Ia perkujtojme pretenduesit se procedura e prokurimit behet me qellim te vleres per para dhe asnjehere nuk lejohet qe te permbillet nje procedure me çmimet me te larta se sa çmimet e tregut;

-Lidhur me pretendimin tjeter se oferta e tij ne asnje rrethane nuk e tejkalon vleren e parashikuar kemi obligim ti sqarojme se tek tenderet me çmimin e poentuar nuk mund te parashikohen sasite dhe per kete kerkohet çmimi per njesi ndersa sasia e kerkuar do te dihet gjate implementimit te kontrates dhe sigurisht do te ishte jonormale dhe e pakuptimte sikur çmimet e dhena per nga nje njesi te tejkalojne vleren e parashikuar. Çmimi i peshuar ne kete rast sherben vetem per vleresim ndersa pagesa duhet te behete sipas çmimeve per njesi qe nenkupton automatikisht se AK-ja duhet te kete kujdes qe te mos pranoj çmime mbi çmimet e tregut dhe realisht kete e kemi bere.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit